



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:033608

Datë: 24.05.2022

Numri i dokumentit: 03052026

P. nr. 1005/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Z nga fsh....., K. e Gjilanit, për shkak të veprës penale, Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-së, e sipas Aktakuzës së Prokurorisë sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, verbal dhe publik, më datën 04.05.2022, mori dhe në prezencë të palëve, publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 23.05.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E.Z , me nr. Personal....., nga babaidhe nëna....., e lindur....., i lindur më datënë fsh....., K. e Gjilanit, ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 22.06.2018, rreth orës 09.45 min., në fshatin....., K. e Gjilanit,, i ka penguar personat zyrtarë të KEDS-it, R .S, dhe J.S. , në asistencë të zyrtarëve policorë, B,M dhe A.S në kryerjen e detyrës zyrtare, në atë mënyrë që derisa të njejtit kishin shkuar sipas urdhërit të KEDS-it që ta bëjnë zhvendosjen e njehsorit prej shtëpisë së tij në shtyllë elektrike, ai kishte kërkuar që të largohen nga aty, duke i ofenduar se kinse nuk posedojnë leje dhe autorizim nga gjykata, mirëpo, për të mos eskaluar situata kanë ndërhyrë policëte lartëcekur, të cilët kanë kërkuar edhe ndihmë nga stacioni policor dhe e kanë arrestuar tani të akuzuarin, pastaj, zyrtarët e KEDS-it e kanë kryer punën e tyre,

-me çka ka kryer veprë penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-së, andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21, 72, 107 të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

ME DËNIM ME BURG

me **Dënim Burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve**, të cilin dënim do ta vuajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Në bazë të nenit 39 par.4 nënpar. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të akuzuarit i shqiptohet taksa në shumën prej 30 (tridhjetë) €.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë **paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për realizimin e kompensimit material, palët e dëmtuara udhëzohen në kontest civil

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP.nr.905/2018, të datës 31.07.2018, kundër të akuzuarit E...., për shkak të veprës penale, Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim merititor.

Në shqyrtimin gjyqësor më dt. 04.05.2022, prokurorja, sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, bëri rikualifikimin e veprës penale sa i përket paragrafit të nenit 409 , për faktin se të dëmtuarit nuk janë zyrtarë policorë, e as të veshur me një autorizim tjetër shtetëror, përkundër se janë persona zyrtarë dhe në këtë rast vepra penale duhet të jetë nga neni 409 par.1 i KPRK.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datë 04.05.2022, në të cilin kanë prezantuar prokurorja e prokurorisë Themelore në Gjilan, Leonora Kadriu, e cila gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se duke u bazuar në rrjedhën e këtij shqyrtimi gjyqësor , adminishtrimit të provave nga provat e shtjelluara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si përfaqësuese e akuzës mbetet në tërësi dhe propozimeve të saj, meqë konsideron se u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë se vepra penale është kryer nga i pandehuri, e një fakt të tillë e dëshmoi edhe dëshmitari N.A , i cili deklaroi se për shkak të pengesave në kryerjen e detyrave zyrtare të punëtorëve të KEDS-it, ka qenë i ftuar në asistencë për t'iu kryerjen e detyrave dhe se i pandehuri gjatë intervistimit nuk kishte qenë fare kooperativ, fakt të cilin e dokumentoi edhe i dëmtuari, dëshmitari ri.J.S , i cil deklaroi se në ditën kritike bashkë me kolegët deisa ishin në detyrë, me asistencë të policisë, ishte krijuar një tollovi dhe ky fillimisht nuk kishte kuptuar, por, i pandehuri e kishte fyer dhe bërtitur dhe i ishte drejtuar me fjalë kanosëse, se nëse nuk largohej nga aty, do të shkonte te shtëpia e tij dhe do të kishte punë me te, këtë e ka vërtetuar edhe i dëmtuari-dëshmitari A.M , i cili ka deklaruar se i pandehuri nuk i kishte lejuar të afroheshin për ta marrë njehsorin, edhe pse ia kishin shpjeguar se e kishin për detyrë ndërrimin e njehsorit për shkak të borxhit, por, ai ka ofenduar me fjalë dhe nuk u është bindur as policëve që ishin në asistencë , për çka edhe i shin detyruar të thërrasin asistencë shtesë, poashtu, këtë e vërtetoi edhe i dëmtuari-dëshmitari A.A , poashtu, punëtor në

KEDS, i cili ka deklaruar se sjellja e të pandehurit ishte tejet e vrazhdë. Kjo është vërtetua edhe nga deklaratat e R.S , punëtor në KEDS dhe nga raporti i oficerit A.S, ku në mënyrë të detajuar ka përshkruar veprimet e ndërmarra gjatë asistimit në këtë rast. Gjiithashtu, prokuroria konsideron se kjo u argumentua edhe nga vet i pandehuri, në përgjigje, ishte edhe jo kooperativ dhe mospërfillës në gjykatore, por, merreni me mend se çfarë sjellje ka pasur te shtëpia e vet , andaj, duke u bazuar në këto rrethana, propozon që të pandehurin ta shpallin fajtor dhe t'i jepet një dënim meritator sipas ligjit, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, e që në rastin konkret konsideron se ka vetëm rrethana rënduese, të kihet parasysh mënyra e kryerjes së veprës penale, rrezikshmëria shoqërore, faktin se me këto veprime nuk janë penguar vetëm individë të caktuar, por, persona zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare , të kihet parasysh peshsa e veprës penale, pasojat e shkaktuara, në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit, dhe kjo të shërbejë për parandalimin e të pandehurti që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale si deh në rehabilitimin e tij, në parandalimin e persoave të tjerë nga kryerja e verpave penale si dhe me këtë të shprejhet gjykimi shoqëror për veprën penale.

I akuzuari E.Z, në fjalën përfundimtare deklaroi se në asnjë mënyrë nuk u vërtetua se e ka kryer veprën penale e cil i vihet në barrë , për arsye se kërkesa e tij në ditën e cekur ka qenë vetëm të respektohet ligji dhe kushtetuta në harmoni me të drejtat dhe liritë e njeriu, të cilat janë të garantuara edhe në Republikën e Kosovës, andaj, obligohemi dhe i bindemi, si personat fizik dhe juridik, për respektimin e privatësisë në pronën private, e cila e amneston nga vepra që i vihet në barrë, kështu që kërkon të respektohet ligji dhe kushtetuta.

Kompetenca e gjykatës

Kompetenca territoriale - Gjyqtari ka vlerësuar se Gjykata Themelore në Gjiilan, duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se vepra penale është kryer në Gjiilani, që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate.

Kompetenca lëndore- duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetent për ta gjykuar një çështje, ku i akuzuari akuzohet për shkak të veprës penale, Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi .1 të KPRK-së për këtë vepër penale, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muajve deri në tri (3) vjet.

Konstatimet e Gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik dhe dëgjimit të dëshmitarëve dhe procedimit të provave formale e materiale, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se është provuar se i akuzuari i lartcekur e ka kryer veprën penale, Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që i njëjti i ka penguar zyrtarët e autorizuar të KEDS-it për ta kryer punën e tyre, duke i ofenduar dhe duke kërkuar që të largohen nga oborri i tij,

Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari E.Z nuk e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova:

- Raporti fillestar i Incidentit me nr.2016-CA-0773, i dt.22.06.2018,
- Raporti i oficerit A.S , i dt. 22.06.2018,

- Raporti i oficerit N.A, i dt. 22.06.2018,
- Kallximi penal me nr. 2016-CA-0773, i dt.22.06.2018

Në pajtim me palët, pasi që Gjykata e Apelit nuk ka dhënë vërejtje lidhur me deklaratat e dëshmitarëve, gjyqtarja , në seancën gjyqësore të dt. 04.05.2022 morri aktvendim për leximin e deklaratave të dëshmitarëve.

Në cilësi të dëshmitarit në seancën Gjyqësore të dt.23.06.2020 është dëgjuar I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, R.S punëtor i KEDS-it, i cili në mes tjerash ka deklaruar se detyra e tij ka qenë çkyqja e njehsorëve elektrik, pa marrë parasysh arsyen e ndërrimit të tyre, pas urdhërave që i merr nga udhëheqësi dhe i kujtohet për cilin rast bëhet fjalë, dhe tani të akuzuarin për herë të parë e ka parë në ditën kritike, ku kanë qenë ky me kolegët A.A, J.S dhe A.M dhe me dy policë dhe e di se kur i kanë treguar arsyen e shkuarjes së tyre, i njeti nuk i ka lënë të hyjnë në oborr, me sjellje shumë të ashpër, së pari i ka thënë Jovicës “ta gjej shtëpinë”, edhe pse këta ia kanë treguar urdhëresën e lëshuar nga udhëheqësi i tyre, i akuzuari ka kërkuar autorizim nga gjykata. Shtoi se vetëm pasi i akuzuari është arrestuar, këta kanë mundur ta kryejnë punën e tyre..

Në cilësi të dëshmitarit në seancën Gjyqësore të dt.23.06.2020, është dëgjuar edhe i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, A.A , poashtu, punëtor i KEDS-it, i cili ka deklaruar se në ditën e cekur si në Kallëzim Penal, bashkë me kolegë tR.Ss , A.M dhe J.S kanë shkuar tek i akuzuari për ta bërë zhvendosjen e njehsorit elektrik nga shtëpia në shtyllën elektrike, për shkak të borxhit që ka pasur i njeiti, por ai i ka penguar ta kryejnë punën e tyre, duke u tbrëtitur vazhdimisht me fjalët, se po hyni në pronë private pa leje, a keni leje nga gjykata, etj., duke e fyer edhe kompaninë, për çka, kanë qenë të detyruar të kërkojnë asistencë nga policia, pastaj, vetëm pasi i akuzuari është arrestuar, këta kanë mundur ta kryejnë punën e tyre. Ai shtoi se njehsori elektrik është prone e KEDS-it dhe këta kanë të drejtë të qasen kudo që ai është i vendosur.

Në seancën kryesore më datë 02.09.2019, është dëgjuar edhe i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, A.M , i cili ka deklaruar se kanë pasur urdhëresë nga drejtoria për ta bërë zvnedosjen e njehsorit elektrik te i akuzuari, për shkak të borxhit që ka pasur, por, i njeiti i ka penguar, duke iu drejtuar kolegut R.S me fjalët : “malok, po folshe shumë”, duke qëndruar 2-3 m. larg shportës dhe nuk i lejonte të afrohen te shtëpia e tij për ta marrë njehsorin, edhe pse këta ia kanë spjeguar se e kanë për detyrë nga drejtoria për ta ndërruar njehsorin, por, ai prapë nuk ka pranuar, derisa kanë ardhur policët, por, ai ka bërë fjalë edhe me ta, për çka, ata janë detyruar të kërkoj në asistencë, të cilët e kanë arrestuar. Shtoi se i akuzuari nuk i ka sulmuar asnjërin nga punëtorët, por, i ka penguar me fjalë.

Më datë 14.10.2020, janë dëgjuar i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, J.S dhe dëshmitari N.A.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, J.S , deklaroi se se meqë ka kaluar kohë e gjatë nga rasti në fjalë, mund të ketë harruar diçka, duke shtuar se data nuk i kujtohet, por, e di se ka qenë mëngjes dhe ky, si vozitës i kamionit të KEDS-it, ka shkuar me ekipin dhe asistencën e policisë në fsh.ë dhe ky e ka bartur mjetin për ngritjen e shportës afër shtyllës elektrike, pastaj, ka ndodhur një tollovi, por, nuk ma kuptuar se çfarë po ndodhë, pasi nuk e kupton gjuhën shqipe dhe i kujtohet se pas kësaj, policia e kanë arrestuar tani të akuzuarin pasi e kanë ftuar patrollën tjetër në asistencë. Përderisa i njeiti në fillim deklaroi se i akuzuari nuk i është afruar personalisht këtij, pas ballafaqimit nga ana e prokurores me deklaratën e tij në polici, ku ka

deklaruar se “i pandehuri është afruar afër kamionit, ka filluar të fyejë dhe të bërtasë që ne të zbresim, sepse, kjo është prone e tij, pastaj, kur ka kuptuar se jam serb, më është afruar dhe ka thënë sërbisht se nëse ti nuk largohesh, unë do të vi te shtëpia jote dhe do të kesh punë me mua”, u kujtua se fjalët e para të të akuzuarit ia ka përkthyer kolegu, dhe pastaj, vërtetë i akuzuari ia ka thënë fjalët e cekura, por, meqë për herë të parë i ka ndodhur një gjë e tillë, është frikësuar, ndërsa, shtoi se ia falë të akuzuarit pasi që nuk e ndien veten të kërcënuar.

Dëshmitari N.B, zyrtar policor, deklaroi se kur ky ka arritur në vendin e ngjarjes në fjalë, pas pas thirrjes nga kolegët dhe e ka shoqëruar të akuzuarin për në stacionin policor, ku edhe e ka intervistuar, me ç’rast, i akuzuari nuk ka qenë fare kooperativ as me te dhe as me avokatin mbrojtës.

I akuzuari E.Z, në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin e fundit gjyqësor, deklaroi se në ditën kritike kanë ardhë punëtorët e KEDS-it për ta transferuar orën e rrymës nga shtëpia në shtyllë, me ç’rast ky u ka kërkuar autroizim nga gjykata dhe meqë ata nuk e kanë dhe ky u ka kërkuar nga ata që ta lëshojnë oborrin, por, ata nuk e kanë lëshuar, për çka, pastaj, ky, i ka kundërshtuar në shfrytëzimin ecpronës së tij personale, për çka edhe ka lindë mosmarrëveshja, edhe pse ky nuk i ka kundërshtuar me ton të ngritur të zërit, por, në mënyrë normale dhe tha se e din se njehsori elektrik është pronë e përbashkët e KEDS-it dhe e tij dhe nuk i ka kundërshtuar në qasje të orës, por, në pronën e tij private, oborr.Punëtorët e KEDS-it kanë trokitur në derë , por, ky nuk ka pasur nevojë t’ua hapë atë, pasi që ka qenë e hapur, ndërsa, njehsorin e ka pasur të vendosur në para-hyrje të shtëpisë.

Shtoi se punëtorët e KEDS-it e kanë vendosur orën të njëjtën ditë, pasi i kanë apsur me vete dy policë dhe kanë kërkuar asistencë dhe nuk e di se pse kanë kërkuar asistencë, pasi që ky nuk ka qenë agresiv, përveç se ka kërkuar t’ia lëshojnë oborrin, edhe pse ata ia kanë treguar arsyen e ardhjes në oborr, por, ky u ka kërkuar leje të veçantë nga gjykata, ndërssa, kur i është lidhur ora nuk u ka kërkuar leje nga gjykata dhe as kur kanë ardhur për ta lexuar orën ky nuk i ka parë, sepse nuk ka qëlluar në shtëpi: Mjehërë tha se nuk i kujtohet se a i ka ofenduar punëtorët e KEDS-it, pastaj, tha se nuk i ka ofenduar ata me asnjë fjalë ofenduese, por, vetëm ka kërkuar të dalin nga oborri, pasi nuk kanë pasur autorizim nga gjykata deh nuk i ka lejuar ta bëjnë ndërrimin e orës deri sa kanë ardhur asistencë shtesë. Në pyetje të gjyqtares e ku ka dëgjuar se punëtorët e KEDS-it duhet autroizim nga gjykata për të hyrë në oborr, i akuzuari deklaroi se këtë e ka lexuar në të Drejtën Ndërkombëtare mbi shfrytëzimin e pronës private, duhet të kenë leje të veçantë nga gjykata, ose lejen e tij (duke mednuar në lejen e pronarit të pronës).

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Për të vërtetuar drejt gjendjen faktike Gjukata ka vlerësuar dhe analizuar, provat si në vijim: Raportin fillestar të incidentitme nr. 2018-CA-0773, të dt. 22.06.2018, Raportin e oficerit A.S , të të njëjtës datë, raporti i oficerit N.A , po ashtu i të njëjtës datë, si dhe Kallximi penal me nr. 2018-CA-0773, i dt. 22.06.2018, si dhe deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve, R.S , A .A , J.S dhe A.M si dhe e dëshmitarit N.A , zyrtar polior, të cilët njësoj, e vërtetuan se i akuzuari E.Z i ka penguar këta në kryerjen e detyrës zyrtare, duke tentuar t’i largojë nga oborri i tij, është gjë që e vërtetoi edhe në vet deklarinimin e tij, se nuk i ka lejuar punëtorët e KEDS-it ta bëjnë ndërrimin e nejhssorit deri sa kanë ardhur asistencë shtesë, duke u thirrur në arsyetimin se gjoja punëtorët e KEDS-it duhet të kenë autorizim të veçantë nga gjykata për të hyrë në oborrin e tij, e nga ana tjetër, deklaroi se kur ia kanë lidhur njehsorin elektrik, ky nuk u ka kërkuar punëtorëve të KEDS-it një autorizim të tillë, gjë që bie në kundërshtim me vet deklarinimin e tij lidhur me autorizimin nga gjykata gjithashtu, njëherë ka deklaruar se nuk i kujtohet a i ka fyer me fjalë punëtorët e KEDS-it, pastaj, ka deklaruar se nuk i ka ofenduar ata me asnjë fjalë ofenduese,.

5.Vendimi për ta shpallur të akuzuarin fajtor

Duke u bazuar në këto që u thanë më lartë, gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin për veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që gjykata gjeti se i njëjti është përgjegjës dhe fajtor dhe janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën akuzohet. Se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, e vërtetojnë edhe vet fjalët e të akuzuarit, i cili deklaroi se kanë lindur mosmarrëveshja mes tij dhe punëtorëve të KEDS-it, pasi ai ka kërkuar nga ata që ta lëshojnë oborrin e tij, sepse, sipas tij, duhet leje nga gjykata se për të shkuar në shtëpi private, gjë që nuk është e vërtetë, sepse, njehsorët elektrik janë prone e KEDS-it dhe ata mund të kenë qasje kur të duan, e në pyetjen e gjyqatres se ku ka dëgjuar ai se për këtë duhet leje nga gjykata, i njëjti me ironi, në seancën e mëhershme është përgjegjur se ka dëgjuar duke pirë çaj, ndërsa, tani ka deklaruar se ka lexuar në të drejtën ndërkombëtare për shfrytëzimin e pronës private.

Besimi i plotë iu dha deklaratave të të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve, R.S, A.A i, J.S dhe A.m , si dhe e dëshmitarit N.A , zyrtar policor, të cilët në mënyrë detaje e kanë përshkruar mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale, pasi që të gjithë njësoj deklaruan se i akuzuari E.Z i ka penguar zyrtarë të KEDS-it në kryerjen e punës së tyre zyrtare, si dhe nuk ka qenë bashkëpunues as me policinë, e as me mbrojtësin e tij, ndërsa, nuk iu dha besimi të akuzuarit, i cili për t'i ikur përgjegjësisë penale.

6.Rrethanat mbi bazën e të cilave është shqiptuar dënimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, është njeri familjar, baba i tre fëmijëve, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, dashja për kryerjen e kësaj vepre, pasi që ai nuk e ka kryer veprën penale nga pakujdesia, por, me dashje, sjelljet jo të mira në gjykatë, pasi disa herë është përgjegjur në mënyrë ironike gjatë marrjes në pyetje, si dhe dëmin e konsiderueshëm material shkaktuar të dëmtuarës KEDS.

7.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale , me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Gjykata, duke u nisur nga të gjitha këto i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1005/2021, më datë 23.05.2022

]

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njejtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.